



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 90

Tiranë – E mërkurë, 15 qershor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 43/2022, datë 9.6.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit..... 11713
Vendim i Kuvendit nr. 44/2022, datë 9.6.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit..... 11713
Vendim i Kuvendit nr. 45/2022, datë 9.6.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit..... 11713
Vendim i Kuvendit nr. 46/2022, datë 9.6.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit..... 11714
Vendim i Kuvendit nr. 47/2022, datë 9.6.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit..... 11714
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 271, datë 13.6.2022	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Republikën e Kosovës..... 11714
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 272, datë 13.6.2022	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 206, datë 6.5.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”..... 11715
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 8062, datë 13.6.2022	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Bashkimin Evropian..... 11715
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 105, datë 19.5.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2022..... 11715

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 108, datë 19.5.2022	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11717
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 19.5.2022	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11719
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 110, datë 19.5.2022	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tamara Hydro Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ura e Tamarës”, i përbërë nga tri HEC-e, HEC “Kozhnjë 1”, me kapacitet të instaluar 1900 kw, HEC “Kozhnjë 2”, me kapacitet të instaluar 1000 kw dhe HEC “Tamara”, me kapacitet të instaluar 12088 kw, me kapacitet total të instaluar 14,988 kw.....	11721
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 111, datë 19.5.2022	Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur të vendimit nr. 110, datë 26.4.2021, për depozitimin në ERE të lejes mjedisore të rinovuar.....	11723
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 112, datë 19.5.2022	Mbi kërkesën e shoqërisë “HEC Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a. dhe shoqërisë “HEC Tërvolit” sh.p.k.....	11724
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 19.5.2022	Mbi kërkesën e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a.....	11726
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 490/5, datë 13.6.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 783, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Studim projektim rruga Berat–Ballaban’”	11728

**VENDIM
Nr. 43/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të shkronjës “b”, pika 1, të nenin 8, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zoti Albert Nikolla zgjidhet anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 9.6.2022.

**VENDIM
Nr. 44/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, pika 1, të nenit 8, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zonja Gentiana Sula zgjidhet anëtare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 9.6.2022.

**VENDIM
Nr. 45/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, pika 1, të nenit 8, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zoti Altin Hoxha zgjidhet anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 9.6.2022.

**VENDIM
Nr. 46/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHETIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 8, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Shoqatës së të Përndjekurve Politikë, si dhe me mbështetjen e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gjergj Marku zgjidhet anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 9.6.2022.

**VENDIM
Nr. 47/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHETIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të shkronjës “ç”, pika 1, të nenit 8, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, si dhe me mbështetjen e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Zoti Skënder Vrioni zgjidhet anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 9.6.2022.

**URDHËR
Nr. 271, datë 13.6.2022****PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në njoftimin e marrë nga Republika e Kosovës,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga komuna e Gjakovës për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve;
- e) nënprodukteve të shpendëve.

2. Urdhri nr. 228, datë 1.6.2021, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Republikën e Kosovës”, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë



dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 272, datë 13.6.2022

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR.
206, DATË 6.5.2022, “PËR MARRJEN E
MASAVE KUFIZUESE PËR
PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
NË SHPENDË, NË MJEDISËT E
HAPURA DHE NË TREGJET E
KAFSHËVE TË GJALLA”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 206, datë 6.5.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”, shfuqizohet.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

NJOFTIM

Nr. 8062, datë 13.6.2022

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE DYPALËSHE ME
BASHKIMIN EVROPIAN**

Marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin, nënshkruar më datë 9.2.2022, në Tiranë, ka hyrë në fuqi më datë 30.5.2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 105, datë 19.5.2022

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT PËR MUAJIN PRILL 2022**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 668/7 prot., datë 17.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 3352 prot., datë 5.5.2022, protokolluar në ERE me nr. 656 prot., datë 10.5.2022, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së



energjisë elektrike për muajin prill 2022, ndërsa me shkresën nr. 3598 prot., datë 12.5.2022, ka paraqitur në ERE aplikimin e rishikuar për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin prill 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 3286 prot., datë 29.4.2022, protokolluar me tonën me nr. 626 prot., datë 4.5.2022, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike për muajin prill 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, ndërsa me shkresën nr. 3287 prot., datë 29.4.2022, protokolluar me tonën me nr. 626/1 prot., datë 4.5.2022, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike për muajin prill 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 6 kV dhe 10 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Shoqëria FSHU sh.a. në aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike për muajin prill 2022, për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, ka paraqitur si më poshtë vijon:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF 35 kV, për muajin prill 2022, është 27,84 lekë/kwh, ku sasia e energjisë elektrike prej 4,320,000 kwh në vlerën 120,284,495 lekë, është siguruar në treg të parregulluar me dy procedura, sikurse provuar dhe nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria FTL sh.a. dhe kursi i këmbimit është përdorur ai i datës 30.4.2022, ku 1 euro=120.72 lekë;

- Kostoja administrative për muajin prill 2022, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë në të njëjtën vlerë si viti i kaluar, prej 1,79 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë 0.75 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë 1.5 lekë/kwh.

- Shoqëria FSHU sh.a., në aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike për muajin

prill 2022, për klientët FMF, të lidhur në nivelet e tensionit 20 kV, ka paraqitur si më poshtë vijon:

- Çmimi mesatar i ponderuar për blerjen e energjisë elektrike nga KESH sh.a. për klientët FMF 20 kV, për muajin prill 2022, është 12.00 lekë/kwh, bazuar në shkresën e shoqërisë KESH sh.a. nr. 6197/1 prot., datë 28.12.2021, por nuk evidentohet sasia e energjisë elektrike për këtë muaj;

- Kostoja administrative për muajin prill 2022, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë në të njëjtën vlerë si viti i kaluar, prej 1,79 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë 0.75 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 20 kV, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë 3.9 lekë/kwh.

- Shoqëria FSHU sh.a. ka paraqitur dokumentacionin përkatës për klientët FMF të lidhur në nivelet e tensionit 10/6 kV:

- Në aplikimin e dorëzuar në ERE, çmimi mesatar i ponderuar për blerjen e energjisë elektrike nga KESH sh.a. për klientët FMF 10/6 kV, për muajin prill 2022 është 12.00 lekë/kwh, bazuar në shkresën e shoqërisë KESH sh.a. nr. 6197/1 prot., datë 28.12.2021, por nuk evidentohet sasia e energjisë elektrike për këtë muaj;

- Kostoja administrative për muajin prill 2022, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë në të njëjtën vlerë si viti i kaluar, prej 1,79 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë 0.75 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 10/6 kV, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, do të vijojë të jetë 4.79 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin prill 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:



Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Prill 2022					
PRILL 2022			Nivelet e tensionit		
			35 kV	20 kV	10/6 kV
	Njësia	Çmimi	Çmimi	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	27.840	12.00	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.84	0.36	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	3.90	4.79
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh	32.72	18.80	19.69

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2022, do të jetë:

- 32.72 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.80 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV;
- 19.69 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2022, prej:

- 32.72 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.80 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV;
- 19.69 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 108, datë 19.5.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “PPC ALBANIA” SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 3, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 668/3 prot., datë 13.5.2022, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë ‘PPC Albania’ sh.a., me nr. 373, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 4.7.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “PPC Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 478/1 prot., datë 4.5.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria është mbajtëse e licencës nr. 373, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë



elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 4.7.2017.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Shoqëria ka bërë aplikimin më datë 4.5.2022, brenda afatit të përcaktuar nga rregullorja.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë kryesisht dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “e”. **Plotësuar.**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “d”. **Plotësuar.**

- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- **germa “d”** (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për një nga administratorët e saj.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- **germa “a”** (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapo krijuara vërtetim që nuk kanë detyrime)). Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin përkatës për shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- **germa “b”** (paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit);

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të tri viteve të fundit ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë, ortakut të saj të vetëm, shoqërisë “Public Power Corporation” s.a.;

- **germa “c”** (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera);

Shoqëria nuk përmbush tërësisht kërkesat e kësaj pike të rregullores, pasi nuk janë shprehur qartë vlerat monetare për financimin e veprimtarisë dhe po ashtu nuk është depozituar ndonjë deklaratë/miratim nga shoqëria mëmë se ajo do të financojë veprimtarinë e “PPC Albania” sh.a. sipas vlerave të parashikuara.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- **germa “a”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve);

Shoqëria duhet të paraqesë sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë dhe për vitin e pestë të licencës;

- **germa “b”** (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj);

Në lidhje me sa parashikuar nga shoqëria, përveç faktit që nuk ka përfshirë të 5 vitet e licencës, kjo pikë e rregullores kërkon kapitalin financiar për ushtrimin e veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentin shoqëruar të vërtetimit e të disponimit të kësaj shume (vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj), të cilin duhet ta depozitojë në vijim.

- **germa “c”** (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur);



Shoqëria nuk ka depozituar informacion/dokumentacion në lidhje me këtë pikë të rregullores. Po ashtu rezulton se për të gjitha vitet që ka qenë e licencuar i është vendosur pagesë rregullatore fikse, që aplikohet ndaj të licencuarve që nuk kanë ushtruar veprimtarinë për të cilën janë licencuar. Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të depozituara në ERE nga vetë shoqëria rezulton se ajo ka pasur të ardhura gjatë viteve 2019 dhe 2020. Në këto rrethana shoqëria duhet të paraqesë në ERE informacionin përkatës mbi natyrën e transaksioneve të kryera gjatë kësaj periudhe.

- Shoqëria “PPC Albania” sh.a. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 373, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “PPC Albania” sh.a., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, data 4.7.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 5.7.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 109, datë 19.5.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”; pika 5, pika 1, germa “e”; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 668/4 prot., datë 13.5.2022, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Danske Commodities Albania’ sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 477/1 prot., datë 4.5.2022, ka paraqitur aplikimin për rinovimin e licencës nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Në zbatim të këtij neni shoqëria duhet ta paraqesë aplikimin brenda datës 4.5.2022. Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 4.5.2022, pra brenda afatit të parashikuar sipas këtij neni.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë



elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim - neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “e”, plotësuar;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, germat “b” dhe “d”, plotësuar;

- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b” dhe “d”, plotësuar;

- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për administratorin e saj, në rast se ai rezulton rezident në Shqipëri;

Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore).

Shoqëria duhet të informojë se si ka vijuar procesi i apelimit administrativ dhe i shlyerjes së detyrimeve ndaj institucionit tatimor;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione, të tjera, etj.).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacion mbështetës financiar në të cilin shprehen qartë vlerat monetare që do t'i shërbejnë kësaj veprimtarie;

Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8:

- germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE kapitalin financiar për ushtrimin e veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacion mbështetës.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet për pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 110, datë 19.5.2022**

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“TAMARA HYDRO ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“URA E TAMARËS”, I PËRBËRË NGA
TRI HEC-e, HEC “KOZHNJË 1”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1900 kw,
HEC “KOZHNJË 2”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1000 kw DHE HEC
“TAMARA”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 12088 kw, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 14,988 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 3 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, me nr. 668 prot., datë 11.5.2022, “Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Tamara Hydro Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Tamara Hydro Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 571 prot., datë 15.4.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Ura e Tamarës”, i përbërë nga ndërtimi i tri HEC-ve, HEC “Kozhnjë 1”, me kapacitet të instaluar 1900 kw, HEC “Kozhnjë 2”, me kapacitet të instaluar 1000 kw dhe HEC “Tamara”, me kapacitet të instaluar 12088 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Cemit të Vuklit, Bashkia Malësi e Madhe, qarku Shkodër.

- Më datë 28.4.2022 ka mbërritur nëpërmjet postës elektronike mandat pagesa e aplikimit për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike e kryer nga shoqëria “Tamara Hydro Energy” sh.p.k.. Në të tilla kushte në mbledhjen e Bordit të datës 28.4.2022 (ku do të relatohej relacioni nr. 579/3 prot., datë 22.4.2022), duke qenë se nga shoqëria u dokumentua kryerja e pagesës së aplikimit, u vlerësua tërheqja nga rendi i ditës i relacionit të depozituar dhe vijimi me shqyrtimin e dosjes së aplikimit të shoqërisë “Tamara Hydro Energy” sh.p.k., duke konsideruar afat aplikimi pikërisht datën 28.4.2022, datën e kryerjes së pagesës për aplikim.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është pjesërisht i plotësuar dhe më poshtë veçojmë dokumentacionin që mungon dhe atë të plotësuar pjesërisht:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB).

Nuk është depozituar certifikata e regjistrimit pranë QKB-së.

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

Mungojnë vërtetimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përkatësisht për vetë shoqërinë dhe njërin prej administratorëve.

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licence prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik);

Shoqëria nuk ka depozituar strukturën e ndërtimit dhe funksionimit të saj dhe licencën e drejtuesit teknik elektrik.

- germa “f” (marrëveshje koncensionit apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhura me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës si dhe ndryshim të këtyre akteve);

Shoqëria nuk ka përcjellë kontratën shtesë të koncesionit (nëse ka) të nënshkruar me MIE-n për ndryshimin e parametrave



hidroenergjitike të HEC-eve, për nënshkrimin e së cilës ka rekomanduar edhe Grupi i Oponencës Teknike në raportin e tij.

- germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme etj.);

Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacion që vërteton pronësinë për zonën ku do të shtrihet projekti dhe në rast riaplikimi brenda afateve ligjore duhet të bëjë me dije si ka vijuar komunikimi respektiv me bashkinë Malësi e Madhe për pajisjen me certifikatë pronësie dhe më tej nënshkrimin e kontratës për dhënie në përdorim të zonës ku do të shtrihet projekti i HEC-eve. Nëse disponohet dokumentacion i përditësuar rreth këtij rregullimi, shoqëria duhet ta depozitojë në ERE.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera).

Konstatohet se mungojnë dokumentet që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen e saj financiare, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit për projektin e HEC-eve “Kozhnje 1”, “Kozhnje 2” dhe “Tamara”.

Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1

- germa “a” (të dhëna teknike për HEC-et “Kozhnje 1”, “Kozhnje 2” dhe “Tamara”).

Mungojnë të dhënat në lidhje me vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit për të tri HEC-et “Kozhnje 1”, “Kozhnje 2” dhe “Tamara”.

- germa “c” (oponenca teknike e projektit).

Konstatohet mungesë e opoenecës teknike të kryer për projektin e zbatimit të hartuar përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit të formës BOT (ndërtim – operim – transferim) për ndërtimin e hidrocentralit

“Ura e Tamarës”, me nr. 186 REP., nr. 101 KOL., datë 15.1.2019.

- germa “e” (miratimi i projektit të zbatimit nga MIE).

Konstatohet mungesë e miratimit të MIE-s për opoenecën teknike të kryer për projektin e zbatimit të hartuar përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit të formës BOT (ndërtim – operim – transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “Ura e Tamarës” me nr. 186 REP., nr. 101 KOL., datë 15.1.2019.

Dhe po ashtu edhe mungesë e miratimit të MIE-s për opoenecën teknike nr. 14/5 prot, datë 27.5.2020, të kryer për projektin e zbatimit të HEC-eve “Kozhnje 1”, “Kozhnje 2” dhe “Tamara” të shoqërisë koncesionare “Tamara Hydro Energy” sh.p.k., në të cilën është rekomanduar nga AKBN-ja edhe nënshkrimi i një kontrate shtesë koncesioni.

Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5.

- germa “a” (miratimi i pikës së lidhjes me sistemin).

Shoqëria nuk ka depozituar miratimin përkatës të pikës së lidhjes se HEC-eve me sistemin elektroenergjitik.

- germa “b” (leja e përdorimit të ujit).

Shoqëria nuk ka depozituar leje të përdorimit të burimit ujor për tri HEC-et për të cilat kërkon licencim.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të sipërcituar, do të njoftohet subjekti që në rast se paraqet aplikimin e ri sipas kërkesave të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tamara Hydro Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kozhnje 1”, me kapacitet të instaluar 1900 kw, HEC “Kozhnje 2”, me kapacitet të



instaluar 1000 kw dhe HEC “Tamara”, me kapacitet të instaluar 12088 kw, me kapacitet total të instaluar 14,988 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 111, datë 19.5.2022

**MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES
SË BORDIT TË ERE-s NË LIDHJE ME
PLOTËSIMIN E KUSHTIT TË
VENDOSUR TË VENDIMIT NR. 110,
DATË 26.4.2021, PËR DEPOZITIMIN
NË ERE TË LEJES MJEDISORE
TË RINOVUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në ERE me nr. 668/6 prot., datë 16.5.2022, “Mbi pezullimin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur të vendimit nr. 110, datë 26.4.2021, për depozitim në ERE të lejes mjedisore të rinovuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 248, datë 13.12.2021, vendosi, ndër të tjera, të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e vendimarrjes së ERE-s për plotësimin e kushteve të vendosura në vendimin nr. 110, datë 26.4.2021.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimarrje, me shkresën nr. 961/15, datë 28.12.2021, duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 110, datë 26.4.2022, është vendosur ndër të tjera, që shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE lejen e mjedisit të rinovuar, dokumentacionin ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik dhe të përditësorë në mënyrë periodike ERE-n mbi statusin e realizimit të planit të veprimit, në zbatim të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2021.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me lejen e mjedisit, shoqëria ka bërë me dije më herët se nga takimet me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), doli në pah se për të vijuar me aplikimet sipas procedurave ligjore duhet të merret më parë autorizimi paraprak nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Pa autorizimin paraprak të MIE-s, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) nuk mund të pranojë aplikimin për leje mjedisore, i cili sikurse dokumentuar edhe më parë në ERE është bërë dy herë dhe është refuzuar për arsyen e sipërcituar. Në këto rrethana, shoqëria është shprehur se po procedon me aplikim pranë MIE-s që më pas të mund të aplikojnë sërish pranë MTM-së për t'u pajisur me leje mjedisore. Në vijim të sa depozituar, në seancën dëgjimore shoqëria mbajti të njëjtin qëndrim dhe ka deklaruar se është e detyruar t'i nënshtrohet kërkesave të autoriteteve përkatëse në lidhje me marrjen e të gjitha lejeve dhe autorizimeve për të vijuar me zbatimin dhe vënien në punë të projektit eolik, kjo edhe në kuadër të Statusit të Investitorit Strategjik me të cilin është pajisur. Në këto rrethana shoqërisë iu kërkua të qartësojë/saktësojë marrëdhënien e saj me ERE-n në kuadër të mbajtjes ose jo të licencës që disponon. Përfaqësuesi i shoqërisë deklaroi se në vijim do të merrte pjesë në një takim me MIE-n, në kuadër të pajisjes me miratim paraprak dhe se në këto rrethana ishte i paqartë për të përcaktuar



vazhdimësinë ose jo të licencës së lëshuar nga ERE.

- Me shkresën e datës 28.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 168/2 prot., datë 28.3.2022, shoqëria ka bërë me dije se që nga zhvillimi i seancës dëgjimore në ERE nuk ka ndryshuar asgjë dhe është në pritje të përgjigjeve zyrtare për kërkesat e saj nga AIDA dhe MIE, të cilat po vonojnë jo për faj të shoqërisë, ndaj nuk mund të përditësojë ERE-n me informacione të mëtejshme.

- Në nenin 66, pika 1, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Për sa bërë me dije nga shoqëria, duke marrë në konsideratë sa referuar dhe më parë, që plotësimi i kushtit që lidhet me lejen e mjedisit nuk varet vetëm nga vullneti apo përpjekja e shoqërisë, por edhe nga organet/institucionet kompetente, po ashtu duke mbajtur parasysh dhe faktin që shoqëria mban statusin e investitorit strategjik, vlerësojmë pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për sa i takon kushtit të depozitimit nga ana e shoqërisë të lejes mjedisore, derisa këto organe të shprehën në lidhje me këtë dokument.

- Në vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2021 është përcaktuar se statusi “Investim/investitor strategjik procedure e veçantë”, jepet për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare), pra deri më 4.2.2023, ndaj dhe pezullimi i vendimmarrjes së ERE-s do të ketë afat vendimtar, afatin e përfundimit të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në vendimin nr. 110, datë 26.4.2021, për depozitimin në ERE të lejes mjedisore të rinovuar nga shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k.

2. Shoqëria të përditësojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, mbi ecurinë e pajisjes me lejen mjedisore të rinovuar.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ana e ERE-s, por jo më vonë se data 4.2.2023, kur është dhe afati i përfundimit të statusit “Investim/investitor strategjik procedure e veçantë”, të dhënë me vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2022.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit në lidhje me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 112, datë 19.5.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC TËRVOLIT” SHPK, PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” (FTL) SHA DHE SHOQËRISË “HEC TËRVOLIT” SHPK

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “a” dhe “ë”; të nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 23, pika 12, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë



8.7.2016, dhe “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet ‘Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike’ (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 668/5 prot., datë 13.5.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC Tërvolit’ sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ (FTL) sh.a. dhe shoqërisë ‘HEC Tërvolit’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Tërvolit” sh.p.k. ka depozituar në ERE shkresën e datës 29.3.2022, protokolluar me nr. 6/6 prot., datë 29.3.2022, me lëndë “Vijueshmërinë e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike nr. 227/15, datë 23.1.2020, nënshkruar ndërmjet shoqërisë ‘HEC Tërvolit’ sh.p.k. dhe shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ (FTL) sh.a.”.

- Neni 20, germa “ë”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e ERE-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet, në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve, sipas parashikimeve të këtij ligji. Gjithashtu, ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, në nenin 98, pika 1, njeh autoritetin e ERE-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve në sektorin e gazit natyror, si dhe ndërmjet tyre dhe klientëve.

- Rregullorja për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016, në nenin 11, pika 11.1, parashikon se: “Çdo i licencuar, ka të drejtë të paraqesë me shkrim, pranë ERE-s, një kërkesë për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, të lindur mes tij dhe një, ose më shumë të licencuari/ve tjetër”.

- Përveç sa më sipër, në nenin 20, pika 1, të “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet ‘Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike’ (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë

23.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: “Në rast të mosmarrëveshjeve, blerësi dhe shitësi do të bëjnë fillimisht përpjekje të zgjidhin konfliktin me mirëkuptim. Nëse palët nuk gjejnë mirëkuptim, ato mund të kërkojnë ndërhyrjen e ERE-s”.

- Në zbatim të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, në nenin 12, pika 12.1.1, parashikon si fazë të parë të investimit të ERE-s pranimin e kërkesës me shkrim për shqyrtimin e mosmarrëveshjes.

- Rezulton se shoqëria “HEC Tërvolit” sh.p.k. është licencuar për prodhimin e energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 57, datë 2.6.2008, me licencën nr. 58, seria NPM08K. Gjithashtu, shoqëria FTL sh.a. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.9.2018, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me licencën nr. F18, me afat vlefshmërie deri më 30.9.2023.

- Në të njëjtën kohë, VKM-ja nr. 244, datë 30.3.2016, e ndryshuar, mbi “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, vendos detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE.

- Kontratat ekzistuese që OSHEE sh.a. ka me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë transferuar te shoqëria FTL sh.a., bazuar në aktet e brendshme ligjore/administrative ndërmjet shoqërive. Në këto rrethana, palët legjitimohen për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nga ERE sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi.

- Në mbështetje të neneve 13 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 26, pika 1, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, me urdhrin nr. 75, datë 13.5.2022, është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë shoqërisë “HEC Tërvolit” sh.p.k. dhe “Furnizuesit të Tregut



të Lirë” (FTL) sh.a., në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HEC Tërvolit” sh.p.k. për zgjidhjen e kontratës me nr. 227/15 prot., datë 23.1.2020, lidhur ndërmjet palëve.

- Në zbatim të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, neni 12, pika 12.1.1, parashikon si fazë të parë të investimit të ERE-s pranimin e kërkesës me shkrim për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, si dhe duke konsideruar se palët prej kohësh kanë vijuar komunikimet shkresore për këtë mosmarrëveshje, vlerësohet e nevojshme pranimi për shqyrtim nga ERE i mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “HEC Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “HEC Tërvolit” sh.p.k. dhe shoqërisë “FTL” sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 113, datë 19.5.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SHPK PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE, SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SHPK, SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SHA DHE SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “a” dhe “ë”; të nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 23, pika 12, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016, dhe “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet ‘Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike’ (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 668/2 prot., datë 13.5.2022, “Mbi kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k. dhe shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a.”,

konstatoi se:

- Më datë 25.5.2021, nëpërmjet shkresës nr. 62 prot., shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. i është drejtuar me kërkesë ERE-s, në lidhje me kompensimin e energjisë për periudhën nga data 15.11.2019 deri në datën 30.4.2021, dhe ka vënë në dijeni dhe shoqërinë FLT sh.a., me anë të shkresës nr. 697/1 prot., datë 3.6.2021.

- Në përgjigje të kërkesës së shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., ERE është shprehur për njohjen të kompensimit të energjisë elektrike të prodhuar nga ana e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., nga HEC “Backa 1, A, dhe C”, e



lëvruar në sistemin e shpërndarjes dhe bërë pjesë e bilancit energjetik të rrjetit të këtij sistemi duke filluar nga data 15.11.2019 deri më datë 30.4.2021.

- Më datë 18.2.2022, nga ana e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. është depozituar kërkesë për kompensim monetar të energjisë së përfituar nga “FLT” sh.a., (OSSHE Group) gjatë periudhës nga data 15.11.2019 deri në datën 30.4.2021, dhe rezultoi e pa trajtuar si kërkesë apo të ketë kompensim të energjisë së prodhuar.

- Vlera e përlogaritur për kompensim monetar, referuar sasisë në kwh të prodhuar dhe çmimeve të miratuara nga ERE për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralët për periudhën nga data 15.11.2019 deri në datën 30.4.2021 (sipas llogaritjeve të shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.), rezultoi të jetë vlera prej 130.763.110 Lekë.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., përmes shkresës nr. 181 prot., datë 18.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 319 prot., datë 18.3.2022, ka depozituar kërkesë për “Zgjidhje të mosmarrëveshjes lidhur me njohjen dhe kompensimin e energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria, për objektin ‘Ndërtimi i hidrocentralit ‘Backa 1, A dhe C’”.

- Me shkresën nr. 1811/1 prot., datë 18.4.2022, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. depozitoi dokumentacionin shtesë mbi kërkesën për zgjidhje të mosmarrëveshjes. Gjithashtu, me shkresën nr. 4039 prot., datë 6.5.2022, protokolluar në ERE më datë 9.5.2022, me nr. 390/9 prot., shoqëria “FLT” sh.a. depozitoi sqarimet për sa i përket mosmarrëveshjes me shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.

- Neni 20, germa “ë”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar parashikon të drejtën e ERE-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet, në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve, sipas parashikimeve të këtij ligji. Gjithashtu, ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, në nenin 98, pika 1, njeh autoritetin e ERE-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve në sektorin e gazit natyror, si dhe ndërmjet tyre dhe klientëve.

- Rregullorja për “Trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin

e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016, në nenin 11, pika 11.1, parashikon se: “Çdo i licencuar ka të drejtë të paraqesë me shkrim pranë ERE-s, një kërkesë për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, të lindur mes tij dhe një, ose më shumë të licencuari tjetër”.

- Neni 20, pika 1, e “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet ‘Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike’ (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, e ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s parashikohet se: “Në rast të mosmarrëveshjeve, blerësi dhe shitësi do të bëjnë fillimisht përpjekje të zgjidhin konfliktin me mirëkuptim. Nëse palët nuk gjejnë mirëkuptim, ato mund të kërkojnë ndërhyrjen e ERE-s”.

- Në zbatim të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, neni 12, pika 12.1.1, parashikon si fazë të parë të investimit të ERE-s pranimin e kërkesës me shkrim për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, si dhe duke konsideruar se palët prej kohësh kanë vijuar komunikimet shkresore për këtë mosmarrëveshje, vlerësohet e nevojshme pranimi për shqyrtim nga ERE i mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe shoqërisë “FLT” sh.a. dhe OSSH sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 490/5, datë 13.6.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 783, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë

private, që preken nga realizimi i projektit “Studim projektim rruga Berat–Ballaban”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 783, datë 15.12.2021, pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilëve do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “pemëtore”, “ullishte” dhe “kullotë”.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4 396 574 (katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA EMËRORE PARAPRAKE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTT ‘STUDIM PROJEKTIM RRUGA BERAT–BALLABAN’”

Nr.	Pronari						Të dhëna (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Indeksi i hartës	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pas.	Sipërfaqja totale	Sip. (m²)	Çmimi (leke/m²)	Vlera (lekë)		
1	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/16	Kullotë	1875	61	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
2	RUSHIT	SEFEDIN	SALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/2	Ullishte	1800	472	203	95816	95,816	KONF. NGA ASHK BERAT
3	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/3	Ullishte	2275	548	203	111244	111,244	KONF. NGA ASHK BERAT
4	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D) K-34-112(255-B)	1559	9/13	Ullishte	7650	1882	203	382046	382,046	KONF. NGA ASHK BERAT
5	MUSTAFA	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/14	Ullishte	850	262	203	53186	53,186	KONF. NGA ASHK BERAT
6	BP ARAPI			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	16/22	Ullishte	7100	823	203	167069	167,069	KONF. NGA ASHK BERAT
7	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/13	Kullotë	3150	68	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
8	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/17	Ullishte	1475	903	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
9	BP ARAPI			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/16	Ullishte	3175	409	203	83027	83,027	KONF. NGA ASHK BERAT
10	BP MASKA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/26	Arë	4200	332	203	67396	67,396	KONF. NGA ASHK BERAT
11	BP MASKA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	41/27	Ullishte	10500	2241	203	454923	454,923	KONF. NGA ASHK BERAT
12	LEFTER	MYRTO	ARAPI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/3	Ullishte	775	224	203	45472	45,472	KONF. NGA ASHK BERAT
13	EDLIR	SHERIF	TALLAS	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/4	Ullishte	2300	256	203	51968	51,968	KONF. NGA ASHK BERAT
14	BP PALLA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/5	Ullishte	2610	626	203	127078	127,078	KONF. NGA ASHK BERAT
15	PETRIT	ZARIF	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/6	Ullishte	1900	581	203	117943	117,943	KONF. NGA ASHK BERAT
16	SHKELQIM	MALIQ	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	55/11	Ullishte	2540	368	203	74704	74,704	KONF. NGA ASHK BERAT
17	ASQERI	NEXHIP	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	55/12	Arë	3875	543	203	110229	110,229	KONF. NGA ASHK BERAT
18	BP MASKA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	55/19	Ullishte	6300	1028	203	208684	208,684	KONF. NGA ASHK BERAT
19	BP MASKA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	54/12	Arë	3825	262	203	53186	53,186	KONF. NGA ASHK BERAT
20	MYSLIM	ALTI	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	54/10	Arë + tr.	650	45	203	9135	9,135	KONF. NGA ASHK BERAT
21	HASAN	SYRJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	59/5	Arë	3550	217	203	44051	44,051	KONF. NGA ASHK BERAT
22	BP MASKA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	59/6	Arë	5175	595	203	120785	120,785	KONF. NGA ASHK BERAT
23	SEFER	MYFTAR	QORRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	59/7	Arë	1400	128	203	25984	25,984	KONF. NGA ASHK BERAT
24	MYSTEHAQ	SKENDER	DELIBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/1	Arë + tr.	600	198	203	40194	40,194	KONF. NGA ASHK BERAT
25	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/3	Arë	570	90	203	18270	18,270	KONF. NGA ASHK BERAT
26	RUSHIT	FTIM	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/4	Arë	805	138	203	28014	28,014	KONF. NGA ASHK BERAT
27	QERIM	SKENDER	DELIBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/5	Arë + tr.	728	86	203	17458	17,458	KONF. NGA ASHK BERAT
28	PIETREF	TAJAR	SULKAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/6	Arë + tr.	560	164	203	33292	33,292	KONF. NGA ASHK BERAT



29	ENVER	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/7	Arë	465	156	203	31668	31,668	KONF. NGA ASHK BERAT
30	PIETRIT	REXHEP	ZIFLE	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/8	Arë + tr	490	115	203	23345	23,345	KONF. NGA ASHK BERAT
31	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	73/27	Kullotë	850	25	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
32	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	60/42	Arë	1750	1000	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
33	XHEVIT	QAMIL	ARAPI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1558	63/27	Arë	2850	100	203	20300	20,300	KONF. NGA ASHK BERAT
34	FADIL	SERIAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/10	Arë	500	81	203	16443	16,443	KONF. NGA ASHK BERAT
35	LUAN	HALIL	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/19	Ullishte	4775	16	203	3248	3,248	KONF. NGA ASHK BERAT
36	SALI	RUSTEM	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	76/11	Arë	3400	35	203	7105	7,105	KONF. NGA ASHK BERAT
37	FAIK	YZEDIN	BRAUSHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	76/10	Arë	2332	200	203	40600	40,600	KONF. NGA ASHK BERAT
38	BAFTAJAR	REXHEP	ZILFAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/1	Pemëtore	1615	216	203	43848	43,848	KONF. NGA ASHK BERAT
39	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/2	Pemëtore	2420	625	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
40	PIETRIT	REXHEP	ZILFAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/3	Pemëtore	2370	381	203	77343	77,343	KONF. NGA ASHK BERAT
41	ATEM	HABIL	KATILLARI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/4	Pemëtore	1840	145	203	29435	29,435	KONF. NGA ASHK BERAT
42	ISMAIL	ETEM	KATILLARI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/5	Pemëtore	630	47	203	9541	9,541	KONF. NGA ASHK BERAT
43	AGRON	ILJAS	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/6	Pemëtore	2609	331	203	67193	67,193	KONF. NGA ASHK BERAT
44	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/8	Pemëtore	270	270	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
45	KADRI	ASLLAN	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	94/7	Pemëtore	2325	572	203	116116	116,116	KONF. NGA ASHK BERAT
46	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	93/5	Kullotë	500	282	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
47	SELMAN	SKENDER	DELIBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	88/1	Arë	3570	327	203	66381	66,381	KONF. NGA ASHK BERAT
48	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	88/2	Kullotë	8575	82	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
49	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/4	Arë	2050	52	203	10556	10,556	KONF. NGA ASHK BERAT
50	RAPO	SAMI	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	90/14	Pemëtore	120	43	203	8729	8,729	KONF. NGA ASHK BERAT
51	SALI	XHEZO	HASANI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/2	Ullishte	1825	503	203	102109	102,109	KONF. NGA ASHK BERAT
52	VELI	MEHMET	HASANI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/3	Ullishte	1600	102	203	20706	20,706	KONF. NGA ASHK BERAT
53	FTITIM	NUREDIN	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/11	Ullishte	5225	10	203	2030	2,030	KONF. NGA ASHK BERAT
54	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/12	Ullishte	1750	252	203	51156	51,156	KONF. NGA ASHK BERAT
55	BP GJONI, TOSKA, BEHARI, VRAPI, SELFALI			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/14	Ullishte	750	153	203	31059	31,059	KONF. NGA ASHK BERAT
56	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	100	Kullotë	34000	33	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
57	MUSTAFA	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/3	Pemëtore	825	28	203	5684	5,684	KONF. NGA ASHK BERAT
58	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/4	Pemëtore	510	28	203	5684	5,684	KONF. NGA ASHK BERAT
59	DURRE	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/6	Pemëtore	2025	29	203	5887	5,887	KONF. NGA ASHK BERAT
60	GEZIM	BARJAM	KARAFILI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/7	Pemëtore	1950	113	203	22939	22,939	KONF. NGA ASHK BERAT
61	ARTAN	NAZIF	KARAFILI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/8	Pemëtore	2025	269	203	54607	54,607	KONF. NGA ASHK BERAT
62	ARBEN	NAZIF	KARAFILI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90/10	Pemëtore	1000	79	203	16037	16,037	KONF. NGA ASHK BERAT



63	BAFTAJAR	REXHEP	ZILFAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	93/1	Arë	2450	10	203	2030	2,030	KONF. NGA ASHK BERAT
64	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	90	Kullotë	22375	72	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
65	SHYQO	NUREDIN	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/6	Arë	2350	271	203	55013	55,013	KONF. NGA ASHK BERAT
66	FTTIM	NUREDIN	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/5	Arë	2060	110	203	22330	22,330	KONF. NGA ASHK BERAT
67	ALTIN	FAIK	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	73/2	Arë	2350	129	203	26187	26,187	KONF. NGA ASHK BERAT
68	MICO	XHEVAIR	TARAJ	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	90/15	Pemëtore	200	70	203	14210	14,210	KONF. NGA ASHK BERAT
69	ENKELEDA	NUREDIN	TALLASI	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	287/10	Pemëtore	1650	210	203	42630	42,630	KONF. NGA ASHK BERAT
70	ENVER	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	287/13	Pemëtore	3990	157	203	31871	31,871	KONF. NGA ASHK BERAT
71	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	300/89	Kullotë	1700	731	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
72	AGIM	HAXHI	BOZEKU	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	300/90	Ullishte	925	345	203	70035	70,035	KONF. NGA ASHK BERAT
73	HASAN	SYRJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/13	Ullishte	1000	308	203	62524	62,524	KONF. NGA ASHK BERAT
74	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	298/10	Kullotë	20700	585	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
75	MYRTEZA	BRAIM	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	296/1	Arë	10200	408	203	82824	82,824	KONF. NGA ASHK BERAT
76	FTTIM	NUREDIN	TALLA	Bardhajt i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/11	Pemëtore	1700	129	203	26187	26,187	KONF. NGA ASHK BERAT
77	FATOS	KADRI	GERXHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/74	Pemëtore	1010	18	203	3654	3,654	KONF. NGA ASHK BERAT
78	KADRI	XHEVAIR	GERXHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/73	Pemëtore	3335	117	203	23751	23,751	KONF. NGA ASHK BERAT
79	QANI	XHEVAIR	GERXHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/72	Pemëtore	1220	7	203	1421	1,421	KONF. NGA ASHK BERAT
80	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/44	Kullotë	755	291	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
81	AGRON	MURAT	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/41	Pemëtore	1665	182	203	36946	36,946	KONF. NGA ASHK BERAT
82	BUJAR	MURAT	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/40	Pemëtore	400	95	203	19285	19,285	KONF. NGA ASHK BERAT
83	SALI	RUSTEM	KUCI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/45	Pemëtore	4500	336	203	68208	68,208	KONF. NGA ASHK BERAT
84	YLLI	MUHAMET	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/87	Pemëtore	2000	195	203	39585	39,585	KONF. NGA ASHK BERAT
85	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/22	Ullishte	675	107	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
86	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/21	Ullishte	2200	560	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
87	BEHAR	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/18	Ullishte	4975	65	203	13195	13,195	KONF. NGA ASHK BERAT
88	KUJTIM	DANE	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/15	Ullishte	600	49	203	9947	9,947	KONF. NGA ASHK BERAT
89	GANI	DANE	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/14	Ullishte	500	19	203	3857	3,857	KONF. NGA ASHK BERAT
90	BEKIM	LUTO	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/13	Ullishte	600	44	203	8932	8,932	KONF. NGA ASHK BERAT
91	HASAN	SYRJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/12	Ullishte	6175	160	203	32480	32,480	KONF. NGA ASHK BERAT
92	FADIL	SERIJAT	MASKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/11	Ullishte	5200	148	203	30044	30,044	KONF. NGA ASHK BERAT
93	BP. TOSKA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/4	Arë	2625	183	203	37149	37,149	KONF. NGA ASHK BERAT
94	SHEME	DANE	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/3	Arë	1575	25	203	5075	5,075	KONF. NGA ASHK BERAT
95	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/16	Ullishte	950	417	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT
96	SHITET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/18	Ullishte	850	483	0	0	0	KONF. NGA ASHK BERAT



97	DEMIR	MEMET	DEMIRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/19	Ullishte	700	11	203	2233	2,233	KONF. NGA ASHK BERAT
98	SALI	RUSTEM	KUCI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/8	Ullishte	2460	138	203	28014	28,014	KONF. NGA ASHK BERAT
99	AGRON	MURAT	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/7	Ullishte	700	61	203	12383	12,383	KONF. NGA ASHK BERAT
100	HEME	DANE	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/12	Ullishte	4470	322	203	65366	65,366	KONF. NGA ASHK BERAT
102	BP. TOSKA			Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/14	Ullishte	4025	172	203	34916	34,916	KONF. NGA ASHK BERAT
103	SPIRO	QAZIM	SINJATI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	73/1	Arë	2375	263	203	53389	53,389	KONF. NGA ASHK BERAT
	TOTALI												4,396,574	4,396,574	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë